

**FJALA E KRYETARIT TË PREZENCËS NË KONFERENCËN “RRITJA E ROLIT  
TË GRUAS NË QEVERISJE: PREMTIM I MBAJTUR?”  
SESIONI I MBYLLJES**

Shkëlqesia juaj, zonja Topalli,  
Ministër Ksera,  
Z. Rama,  
Z. Meta,  
Shkëlqesi,  
Zonja dhe zotërinj,  
Mirëdita!

Kanë kaluar dy ditë debati dhe diskutimesh që kur pata kënaqësinë të hap këtë konferencë dedikuar projektit *Rritja e Rolit të Gruas në Qeverisje*.

Do të doja të ndaja me ju, nëse më lejoni, disa nga vëzhgimet dhe konkluzionet që kanë dalë nga diskutimet e përbashkëta.

Nuk është për t'u habitur që një pjesë e mirë ishin shkëmbime të sinqerta pikëpamjesh dhe opinionesh në lidhje me zgjedhjet e vitit 2009 dhe 2011, nga këndvështrimi gjinor.

Siç e dimë, numri i grave të zgjedhura në nivel qendror dhe vendor mbetet shumë i ulët.

Nga kjo lind pyetja pse progresi ka qenë kaq i ngadaltë pavarësisht futjes së kuotës gjinore në Kodin Zgjedhor.

Në fakt, kur shohim më nga afër zgjedhjet e majit, vëmë re se rreth 30% e kandidatëve për këshillat bashkiakë dhe komunalë ishin gra.

Kjo tregon qartë se nuk kishte mungesë kandidatësh të përshtatshme gra.

Ku qëndron atëherë mospërputhja midis numrit të grave të zgjedhura dhe atyre kandidate?

Më lejoni të argumentoj se edhe pse mungesa e përputhshmërisë me kuotën gjinore është qartazi një nga arsyet, ajo s'mund të jetë e vetmja arsye.

Së pari, në shumë raste, partitë politike bënë vetëm minimumin e mundshëm – d.m.th duke vendosur emrat e grave kandidate në vend të tretë, të gjashtë dhe ndonjëherë në fund të listës së kandidatëve.

Me fjalë të tjera, edhe pse përmbajtja e ligjit u respektua, fryma që ai përcjell nuk u respektua.

Megjithatë, mund të them se pavarësisht analizimit që mund t'i bëjmë historisë së barazisë gjinore në zgjedhje, një gjë është tepër e qartë:

Gratë vazhdojnë të jenë të nënpërfaqësuar në politikë.

Shumë gra të forta, të afta dhe energjike vazhdojnë të jenë të përjashtuara nga postet e zgjedhura.

Kjo jo vetëm që është e papranueshme – por e dhe e padrejtë.

Partitë politike duhet të bëjnë më shumë në lidhje me respektimin e kuotës gjinore dhe të vendosin emrat e kandidatëve gra në mënyrë më të spikatur në të gjitha listat zgjedhore.

Përforcimi i mëtejshëm i demokracisë brenda partisë do të jetë një pjesë integrale që do të sjellë ndryshim.

Partitë politike duhet të mbështesin më tepër gratë aktiviste në politikë, veçanërisht për sa i përket trajnimit dhe zhvillimit të tyre.

Partitë politike duhet të kujdesen që të ofrojnë vetë trajnim për kandidatët e tyre në vend që të mbështeten shpesh tek programet e ofruara nga donatorët

Zonja dhe zotërinj,

Për të përfunduar fjalën, më lejoni të them se:

Mundësitë që u ofrohen grave të jenë pjesëmarrëse aktive në politikë janë një parametër kyç i një demokracie moderne funksionale, dhe si rrjedhojë një aspekt integral i procesit demokratik në Shqipëri.

Shpjegimi se nën-përfaqësimi aktual i grave është pjesë e 'kulturës shqiptare' nuk mjafton më si justifikim.

Dëgjojmë shpesh nga të gjitha kampet politike të flasin për 'evropianizimin' e tyre.

Tani, është koha të shohim që fjalët e tyre të mira të mbështeten po aq nga veprimet që ndërmerren.

Tani, partitë politike duhet të japin shumë më tepër rezultate.

Ju falemnderit!

**Fund**